



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/ 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 28.09.2023

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “**RATECH**” sh.p.k me NUIS **L11521021S** dhe “**INET**” sh.p.k me NUIS **K81607039F**.

Operatori “**RATECH**” SHPK me adresë: Rruga e Kavajës, pallatet e shoqërisë “Park Construction Albania”, Godina D, Hyrja A, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Operatori “**INET**” SHPK me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ibrahim Rrugova”, Sky Tower, Kati 3, 1019, Tiranë, Shqipëri.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-77503-08-15-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Paisje rrjeti Core (Firewall + Switch + Core Router) në HQ dhe degët e shoqërisë, licenca për akses në distancë, mbrojtje rrjeti dhe paisjesh”, me fond limit **25,600,000 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind mijë)** lekë, pa TVSH. Kohëzgjatja e kontratës: malli do të dorëzohet për 4 muaj kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 21.08.2023, nr. 70

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij njoftimi, ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “**RATECH**” sh.p.k me NUIS L11521021S, & **INET sh.p.k** me NUIS K81607039F me vlerë të ofertës ekonomike **25,100,000** (njëzet e pesë milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH;

2. Operatori Ekonomik “**SINTEZA-CO**” sh.p.k me NUIS K11324003F me vlerë të ofertës ekonomike **22,187,500** (njëzet e dy milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “**COMMUNICATION PROGRESS**” sh.p.k me NUIS K01625001C, i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentacion ligjor, ekonomik e teknik, përveç ekstraktit të QKB-së.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “SINTEZA-CO” sh.p.k me NUIS K11324003F;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që “**SINTEZA-CO**” sh.p.k., nuk i përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe konkretisht;

- a) Në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike ndër të tjera është kërkuar “*Operatori ekonomik fitues do të realizojë dhe upgrade të rrjetit ekzistues duke furnizuar pajisje te reja Firewall, switch të përshtatshme për komunikime sipas kërkesave te Autoritetit Kontraktues. Ri-dizenjimi dhe implementimi i upgrade të pajisjeve dhe infrastrukturës së rrjetit do të ofrojë një infrastrukturë moderne, e cila garanton performancën dhe sigurinë e rrjetit në të gjithë segmentet LAN Access, Core dhe Edge/WAN.*

Licensa duhet të ofrojë funksionet e sigurisë Intrusion Prevention Security Service (IPS), Application Control, Antivirus, Botnet IP ose Domain, Web Filtering, Antispam, Sandbox.

Në ofertën ekonomike të OE Sinteza Co, eshte deklaruar që do të ofrohen modelet firewall sipas modelin 1, modelit 2, modelit 3 perfs hire abonimin 3 vjecar të licensave të sigurisë të tipit Advanced Threat Protection.

Sipas licensimit qe ofron Fortigate, pra prodhuesi i paisjeve te ofruara nga operatori ekonomik Sinteza Co, tipi licences Advanced Threat Protection **nuk i ofron cilesite e kerkuara ne specifikime teknike qe jan Web Filtering dhe Antispam te cilat jane dy cilesi shume te rendesishme per sigurine e rrjetit dhe sisteme te postes shqiptare. Keto dy cilesi ofrohen nga licenca te cilat jane te tipit Unified Threat Protection apo Enterprise Protection.**

- b) Në Shtojcën 7 të DST-ve kriteret e veçanta të kualifikimit 2.3.3, është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve hardware dhe software të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. -Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Autorizimit nga Prodhuesi/distributor i autorizuar.*

(Ky kriter vendoset per te vertuar qe OE eshte i autorizuar nga prodhuesi per te prokuruar mallin objekt prokurimi, ne respektim te menyrave te parashikuara nga LPP, me qellim qe artikujt e kerkuar te jene ne perputhje me kerkesat teknike dhe cilesore te kerkuara).

Në dokumentat e paraqitura në përmbushje të kriterit të sipërcituar rezulton se janë paraqitur:

- Formularin e Autorizimit e Shpërndarjes lëshuar nga distributori “Comtrade Distribution” d.o.o dhe pamjen nga web-i zyrtar i prodhuesit të pajisjeve hardware “Fortinet”, ku vërtetohet që distributori “Comtrade Distribution” d.o.o është partner zyrtar i prodhuesit.
- Autorizimin e Prodhuesit “Sophos” Ltd, që konfirmon që O.E “Sinteza Co” sh.p.k, është i autorizuari zyrtar për rishitjen e mallrave/shërbimeve e produkteve të sigurisë hardëare dhe softëare që ofron prodhuesi.

Gjithashtu, O.E “Sinteza Co” sh.p.k, si pjesë e ofertës ekonomike ka dorëzuar Shtojcën 5-Formularin e Specifikimeve Teknik, ku deklaron rinovimin e licensave për 14 pajisjet ekzistuese FortiGate-50E për periudhën 1 vjecare dhe dorëzimin e pajisjeve të reja ku të përfshihet mbrojtja IPS, URL filter, application control, etj, në rastin e shpalljes fitues.

Në zbatim të Nenit 37 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në zbatim të objektit të kontratës, AK-ja ka përcaktuar në Forumlarin e Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit të dokumentat standarte të tenderit, prokurimin 600 cp licensave ekzistuese “Trellix Protection Suite Enterprise Edition”, që ka në përdorim A.K Posta Shqiptare sh.a. Në dëshmi të sa mësipër Operatori ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k, nuk ka paraqitur Autorizimin e prodhuesit/distributorit për licensën “Trellix Protection Suite Enterprise Edition”, për me tëpër AK pas shqyrtimit të dokumentacionit paraqitur në S.P.E dhe verifikimeve në faqet zyrtare vë re që asnjëri nga prodhuesit “Fortinet” dhe “Sophos” Ltd, si dhe distributorit “Comtrade Distribution” d.o.o, nuk janë të autorizuar për shitjen/shpërndarjen e licensave “Trellix Protection Suite Enterprise Edition”.

Si pjesë e ofertës ekonomike, O.E ka paraqitur dhe Shtojcën 5-Formularin e Specifikimeve Teknike të ndryshuar, ku propozon zëvendësimin e 600 cp licensave egzistuese “Trellix endpoint protection” me “Antivirus Sophos Advanced”. Licenca “Trellix Endpoint Protection”, që A.K ka në përdorim për 600 pajisjet, mirëfunksionon me infrastrukturën ekzistuese dhe është e provuar që ofron mbrojtje gjithëpërfshirëse për rrjetin dhe sistemet. Ndërkohë që, zgjidhja e sygjieruar “Antivirus Sophos Advanced” nuk është kompatibël me infrastrukturën e rrjetit të Postës Shqiptare dhe si e tillë nuk e siguron AK, që do të funksionojë me sukses. Licenca “Trellix Endpoint Protection” dhe “Antivirus Sophos Advanced”, nuk janë të barazvlefshme pasi janë dy lloje të ndryshme zgjidhjesh për sigurinë. Licenca “Trellix Endpoint Protection”, kryen funksione të avancuara që përfshijnë zbulimi dhe parandalimi e ndërhyrjeve së të dhënave, identifikimin e sulmeve të rrjetit dhe mbrojtje të pikës fundore ndërkohë që zgjidhja “Antivirus Sophos Advanced” ofron vëtem mbrojtje kundër ransomware, filtrim në internet dhe viruseve të pikës fundore ku është instaluar.

Alternativa e ofruar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, në mënyrë ekuivalente pasi është zgjidhje sigurie e ndryshme nga ajo e objektit të kontratës së prokuruar.

Në përcaktim të Nenit 92 të L.P.P-s, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor për arsyet e rënditura sa mëpër gjykon se “Sinteza Co” sh.p.k nuk plotëson burimet e nevojshme teknike, për të zbatuar kontratën.

2. “COMMUNICATION PROGRESS” sh.p.k me NUIS K01625001C

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në tender të operatorit ekonomik rezulton që nuk i përmbush kriteret ligjore, ekonomike dhe teknike, pasi nuk ka vendosur në sistem asnjë dokument kualifikues të kërkuar nga Dokumentat Standarte të Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “**RATECH**” sh.p.k me NUIS **L11521021S** me adresë: Rruga e Kavajës ,pallatet e shoqërisë “Park Construction Albania”, Godina D, Hyrja A,1023,Tiranë, Shqipëri dhe “**INET sh.p.k**” me NUIS **K81607039F** me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Ibrahim Rrugova”, Sky Tower, Kati 3,Tiranë, 1019, Shqipëri se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 25,100,000 (njëzet e pesë milion e njëqind mijë) lekë pa T.V.SH., është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” SHA, Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) - Nuk ka

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ardit Demiri